

SYLLABUS I LËNDËS: HISTORIA E MENDIMIT EKONOMIK

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	HISTORIA E MENDIMIT EKONOMIK
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i tretë, Semestri i pestë
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	<i>Caktohet në fillim të vitit</i>
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Luljeta Elezaj
Detajet kontaktuese:	luljeta.elezaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kursi Historia e Mendimit Ekonoik do të ofrojë një mundësi për të kuptuar më mirë se si teoritë ekonomike kanë trajtuar çështjet e mëdha ekonomike, veçanërisht rritjen, teknologjinë dhe novacionin, papunësinë dhe rolin e shtetit në ekonomi. Ky kurs shpjegon se si ekonomia botërore është zhvilluar deri ne ditet e sotme, duke u fokusuar në kërkimin e përcaktuesve të suksesit ekonomik dhe zgjidhjeve të ndryshme që janë ofruar. Historia e mendimit ekonomik merret me mendimtarët dhe teoritë e ndryshme, nga bota e lashtë deri në ditët tona, si dhe kontributi i tyre në zhvillim e ekonomisë politike dhe më vonë ekonomiks. Këtu përfshihen shumë shkolla të ndryshme të mendimit ekonomik. Historia e ekonomiksit merret me origjinën dhe zhvillimin e ideve ekonomike dhe ndërlihdjet e tyre. Është një tregim historik i doktrinave ekonomike. Ky kurs do të gjurmojë evolucionin e të menduarit ekonomik nga shkollaret e hershem deri në fillim të shekullit të njëzetë. Grupet kryesore dhe mendimtarët e përfshijnë Scholastics, Mercantilists, Physiocrats, Adam Smith, Thomas Malthus, David Ricardo, Karl Marx dhe Friedrich Engels, marginalistët e hershëm, Alfred Marshall, John Maynard Keynes etj.
Qëllimet e lëndës:	Objektiv parësor i kursit është të hulumtojë perspektiva të ndryshme që kanë ndikuar në mendimin ekonomik në periudha dhe vende të ndryshme, si dhe për të identifikuar "rrjedhën kryesore" të mendimit ekonomik perëndimor. Objektiv i dytë është vlerësimi kritik i disa kontributeve kryesore në teorinë e vlerës, teorinë e

	prodhimit dhe teorinë e shpërndarjes. Qëllimi i këtij kursi është: • Të njohin studentët me krijimin dhe evoluimin e shkollave alternative të mendimit ekonomik. • Të hulumtohen forcat teknologjike, ideologjike dhe shoqërore që kanë ndikuar në këto shkolla të mendimit dhe teoritë e ndërlidhura që janë përdorur për të shpjeguar dhe analizuar zgjedhje të veçanta. • Të inkurajojë diskutimin dhe studimin se si ngjarjet që ndryshojnë me shpejtësi do të ndryshojnë e shoqërisë (dhe të studentëve) rreth marrëdhënieve ekonomike. Cilat teori të reja ekonomike do të inkurajojnë këto perspektiva të ndryshuara? • Të vlerësojë në mënyrë kritike prirjet kryesore të ekonomisë modern dhe të jetë në gjendje të ndërtojë modele teorike, të analizojë dhe të interpretojë në mënyrë kuptimplote rezultatet e përftuara.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët pritet të: 1. Të jenë në gjendje të identifikojnë idetë kryesore që lidhen me secilin grup ose mendimtar të studiuar, dhe në këtë mënyrë të kuptojnë më mirë origjinën e teorisë bashkëkohore. 2. Të jenë në gjendje t'i vendosin teoritë dhe idetë e studiara brenda kontekstit të kohës në të cilën ato zhvillohen. 3. Të jenë në gjendje të identifikojë teoritë që ndryshojnë rrënjësisht nga teoria moderne kryesore, dhe në këtë mënyrë njohin se baza teorike e ekonomisë ka qenë dhe vazhdon të jetë e kontestuar.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në	4	15	60

shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim	1	4	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet, prezentimet ,etj			
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:	Çdo javë mbahen nga 2 orë ligjërata dhe 1 orë ushtrime. Pas çdo ligjërata jepen detyra për përgatitjen e eseve, të cilat diskutohen në javën në vijim. Studentët inkurajohen që të përcjellin rrjedhat ekonomike gjatë historisë, gazetave, revistat dhe internetin dhe të nxjerrin tema për diskutim. Esetë e përgatitura lidhur me këto çështje merren parasysh në vlerësim. Mësimdhënia do të përqendrohet në pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e mësimin, me prezantime individuale e grupe, me komente mbi ligjëratën/prezantimin e mësimdhënësit etj.		
Metodat e vlerësimit:	Në mënyrë që të ketë një vlerësim sa më të drejtë të punës së studentëve gjatë gjithë vitit, nota përfundimtare është rezultat i aktivitetit të studentëve të treguar gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, vlerësimeve paraprake dhe një provimi përfundimtar. Vlerësimi do të jetë me shkrim. Pyetjet formulohen prej materialit mësimorë që ligjrohet në klasë dhe kanë formën e pyetjeve të shkurtra dhe /ose në formë të eseve. Mënyra e vlerësimit: Testi 1 = 45%; Testi 2 = 45%. Prezantimet seminarike = 10% Në rast se studenti dështon të kalojë lëndën përmes ndërtimit të notës, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit final (kriteri për kalim = së paku 51%). Gjatë vlerësimit do të merren parasysh, përveç tjerash, edhe këto aspekte: - interpretimi i temës, - thellësia e të kuptuarit të temës, - shfrytëzimi i literaturës, - evaluimi dhe sinteza e evidencës, - analizat kritike dhe		

	- logjika e ndërtimit të argumentit. Përveç kësaj, vëmendje në vlerësim do tu kushtohet edhe: - drejtshkrimi, - prezantimi vizual të të dhënave dhe referencave, - gjatësisë së shkrimit dhe - prezantimit të përgjithshëm.
Literatura	
Literatura bazë:	- Sinan Ademaj, Historia e mendimit ekonomik; - Henri Denis, Historia e Mendimit Ekonomik, Papirus, 2010; - John Kenneth Galbraith, Historia e Ekonomisë, Botimet IDK -
Literatura shtesë:	• Hunt, Mark Lautzenheiser, History of Economic Thought, 3rd edition, M.E.Sharpe, 2011. • Rondo Cemerón – Larry Neal, Histori e ekonomisë botërore, prej epokëspaleolitike deri në ditët tona. Oxford Uneveristy Press 2010.

Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje e përgjithshme, Konceptet Kyç
<i>Java e dytë:</i>	Historia e ekonomisë dhe zhvillimi ekonomik
<i>Java e tretë:</i>	Zhvillimi i hershëm ekonomik
<i>Java e katërt:</i>	Idealizmi politik dhe ekonomik në filozofinë Greke dhe rënja e tij
<i>Java e pestë:</i>	Zhvillimi i ekonomisë në Evropën mesjetare
<i>Java e gjashtë:</i>	Lindja e ekonomisë politike dhe konfirmimi i doktrinës liberale.
<i>Java e shtatë:</i>	Diskutime dhe vlerësimi i parë
<i>Java e tetë:</i>	Lëvizja e përgjithshme e ideve ekonomike dhe reformat
<i>Java e nëntë:</i>	Ekonomia politike përballë efekteve revolucionit industrial
<i>Java e dhjetë:</i>	Mendimet kryesore socialiste të shekullit të XIX
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Themelimi i ekonomisë politike neoklasike
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Zhvillimi i përgjithshëm i mendimit ekonomik nga 1875-1939
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Orientimet aktuale të mendimit ekonomik
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Diskutime/Seminare
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Diskutime dhe vlerësimi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shitesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentet inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime lidhur me to. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave , ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.